



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

Lënda : Njoftim për konsultim publik të projekt-vendimeve

Në mbështetje të nenit 18, të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak Durrës përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve zhvillon konsultime.

Në kuadër të këtij procesi, Këshilli Bashkiak publikon në këtë kartelë, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al), faqa e Këshillit Bashkiak, sipas parashikimeve të ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, të gjitha projektvendimet dhe relacionet që do të kalojnë në procesin e konsultimit publik.

Për këtë qëllim, mirëpresim çdo koment dhe sugjerim Tuajin, mbi projekt-vendimet, të cilat duhet të dërgohen në adresën e e-mail: keshillidurres@gmail.com, ose me shkresë pranë protokollit të Bashkisë Durrës, brenda 20 ditëve punë nga publikimi i çdo projektvendimi në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Dorina Milja